

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kush duhet t'i kompensojë viktimat dhe ata që shpallen të pafajshëm në Speciale?
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/kush-duhet-ti-kompensoje-viktimat-dhe-ata-qe-shpallen-te-paf-ajshem-ne-speciale
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:46:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 17:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8e9f3a5374305af86ec3d9f774b2ab08d26241195f6e3f26e2bea9b7aeb735f5
TEKSTI	594db9b116ff4f5f6a55343edb22f61dae49db75d61f2e46b4c466f94820eb79
PAMJA	aabdd9d18893dd8acfd1f6d57d180da3d69a1e45a1ed779b3d43b05df7c5bc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	58f4692cd38a8d643d9b93c6fc697bafc28490e7d03553f6a6228486463a616e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/58f4692cd38a8d643d9b93c6fc697bafc28490e7d03553f6a6228486463a616e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ARBËRI

Kush duhet t'i kompensojë viktimat dhe ata që shpallen të pafajshëm në Speciale?



Foto: Associated Press

Nga: Blendina Veliqi

12 shtator 2026 19:15

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Legjislacioni në fuqi i Kosovës e garanton të drejtën e kompensimit të personave që mund të shpallen të pafajshëm në rastet gjyqësore në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë. Ndërsa, kompensimi i viktimave është obligim ekskluziv i të dënuarit. Specialja ka thënë se në pamundësi që i dënuari ta kryejë këtë obligim, duhet të gjendet një mënyrë alternative për përmbushjen e këtyre urdhrave dhe se Kosova nuk mund t'i ikë obligimit për krijimin e një fondi të veçantë për këtë qëllim

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë në pritje të aktgjyqimit në rastin në të cilin akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë.

Në rast se ish-krerët e UÇK-së shpallen të pafajshëm, çështja e kompensimit për kohën e kaluar në paraburgim mbetet tjetër aspekt që mund të hapet pas përfundimit të procesit gjyqësor.

Avokati Ardian Bajraktari ka treguar se kompensimin e personave që kanë qenë të privuar nga liria, por që janë shpallur të pafajshëm në Speciale e ka barrë Kosova dhe jo Gjykata.

“Kjo është një prej barrës, detyrimeve të shtetit të Kosovës, që e ka marrë me rastin e miratimit të ligjit dhe me sa jam në dijeni, një gjë e tillë nuk është barrë për Dhomat e Specializuara”, ka thënë ai.

Në një përgjigje për KOHËN, zëdhënësjja e DHSK-së, Angela Griep, ka thënë se kuadri ligjor i Gjykatës Speciale parasheh kompensim vetëm në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut.

Edhe



Arbëri • 21 gus 2026

Nëna Thaçi ebnallet i nafaichâm a lirnat

Arbëri.

Aliu: Bashkëpunimi mes universiteteve të Kosovës dhe Shqipërisë, kthesa më e madhe në hapësirën shqiptare

Arbëri.

Aliu: Kosova ka qenë shteti i dytë i shqiptarëve të Jugosllavisë

Futboll.

Fitore e Rrahmanit me Napolin

Futboll.

“Fundi” jo i lavdishëm i karrierës së suksesshme të Rrahmanit te Kosova

Arbëri.

Ali Aliu në PIKE me Veton Surroin (II)

Futboll.

Mbyllet pa gola pjesa e parë e derbit gjilanas



...nëse kjo gjë mund të pengojë procesin
menjëherë?

“Kjo çështje rregullohet me Rregulloren e Procedurës së Dhomave të Specializuara të Gjykatës Kushtetuese. Çdo kërkesë e tillë para Gjykatës Kushtetuese mund të paraqitet vetëm pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike”, ka thënë Griep.

Meqë kuadri ligjor i Gjykatës Speciale nuk e parasheh këtë formë kompensimi, Ministria e Drejtësisë në Kosovë në një përgjigje për KOHËN ka thënë se kjo është e garantuar me ligjin për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencialë në Proceset Gjyqësore në DHSK.

“Kjo e drejtë rregullohet më tej me Udhëzimin Administrativ (MD) nr. 04/2020 për kompensimin e personave të akuzuar për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, të shpallur të pafajshëm me vendim të plotfuqishëm, i cili përcakton procedurën, kriteret dhe mënyrën e realizimit të kësaj të drejte”, thuhet në përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë.

Në të njëjtën kohë, varësisht prej rezultatat të gjykimit del ose jo çështja e kompensimit të viktimave.

Në historinë e Speciales, përveç dënimeve me burg, ka edhe dy urdhra për kompensim të viktimave.

Ngjashëm si Specialja edhe Ministria e Drejtësisë ka thënë se përgjegjësia e pagesës për dëmin i takon ekskluzivisht personit të dënuar.

Edhe



Arbëri • 5 pri 2026

Mbrojtja kërkon lirimin e Thaçit, si argument paraqet vendosmërinë e tij për themelimin e Speciales

E për rastet kur i dënuari s'ka mjete të mjaftueshme për t'i kryer obligimet, nga Ministria e Drejtësisë kanë thënë se ekziston Programi për kompensimin e viktimave të krimit, por që nuk ekziston ndonjë mekanizëm i veçantë për qëllimin e kompensimit të viktimave që kanë qenë pjesë e rasteve të Speciales.

Zyra për Informim e Gjykatës Speciale ka thënë se i ka bërë thirrje Kosovës që të krijojë një mekanizëm për kompensimin e viktimave të krimit që janë nën juridiksionin e DHSK-së. Ata kanë thënë se e kanë parë edhe mundësinë e pranimit të donacioneve vullnetare pa destinim të caktuar me qëllimin që të kontribuohet në pagesën e dëmshpërblimeve. Por, Specialja ka thënë se kjo nuk e liron Kosovën nga përgjegjësia për të krijuar një mekanizëm për dëmshpërblim.

“Në fund, si masë të fundit, trupi gjykues ka vënë në dukje se ekziston mundësia që Dhomat e Specializuara të pranojnë donacione vullnetare pa destinim të përcaktuar, me qëllim që të kontribuohet në pagesën e dëmshpërblimeve të akorduara të viktimave përmes një urdhri përfundimtar për dëmshpërblim të nxjerrë nga Dhomat e Specializuara. Megjithatë, trupi gjykues ka theksuar se një mundësi e tillë në asnjë mënyrë nuk e çliron personin e dënuar nga detyrimet e tij për të kompensuar viktimat dhe as nuk e çliron Kosovën nga përmëshja e detyrimeve të saj ndaj viktimave dhe për të krijuar një mekanizëm për dëmshpërblim”, thuhet në përgjigjen e Griepit.

Avokati Ardian Bajraktari ka theksuar se Fondi për Kompensimin e Viktimave, i cili ekziston në Kosovë, nuk është i natyrës përjashtuese, por që duke i parë dallimet me procedurat që zhvillohen në vend, sipas tij, DHSK-ja duhet të krijojë vetë fondin e saj për këtë qëllim.

“Unë besoj që këto të fundit duhet të krijojnë edhe fondet përkatëse për t'i kompensuar, sepse shumat që janë aprovuar janë jashtëzakonisht të larta dhe dallojnë esencialisht në atë që aplikohet në Kosovë”, ka thënë Bajraktari.

Në Dhomat e Specializuara të Kosovës janë trajtuar tri raste për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Edhe



Arbëri • 9 shk 2026

PDK për kërkesën e Prokurorisë së
Speciales: Po synohet barazimi i viktimës
me agresorin

Rasti i ish-krerëve të UÇK-së është në fazën përfundimtare në
shkallë të parë.

Ndërsa, në dy raste të tjera, Salih Mustafa dhe Pjetër Shala janë
dënuar me burgim si dhe u është shqiptuar urdhër për
dëmshpërblimin e viktimave.

#GJYKATA SPECIALE

#VIKTIMAT

#TE PAFAJSHËM

Artikuj të ngjashëm

Arbëri • 10 sht 2026

Bajraktari: Edhe nëse lirohet në rastin
kryesor, Thaçi përballlet me aktakuzën e
dytë

Arbëri • 2 kor 2026

Hasani për zvarritjet e Speciales: Po të
dërgohen në Gjykatën e Strasburgut, do të
gjente shkelje

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njëjësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

+383 (0) 38 249 105 /

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh
Bush p.n., 10000 Prishtinë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.